




Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	04.02.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTACK	528/2022		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1213/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1213/2021 të datës 23.12.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me

Komuna e Vushtrisë, kundër Vendimit KD-01/2021 të datës 24.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në çështjen juridike “masë disiplinore-largim nga shërbimi civil”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1213/2021 e datës 23.012.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD-01/2021 i datës 24.11.2021 me numër të protokollit 124 i Komisionit Disiplinor të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike sipas akt emërimit me numër të protokollit 126/3 të datës 06.09.2011 në vendin e punës “Zyrtarë i IT-së”, i cili me datë 07.09.2020 ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit 03/2020 për lejimin e pushimit pa pagesë për një (1) vit, për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore pas intervenimit kirurgjik të datës 23.12.2019.

Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike me datën 09.09.2020 merr Vendim me numër të protokollit 109 me të cilin ankuesit i aprovon kërkesën për pushim pa pagesë për periudhën kohore prej gjashtë (6) muaj duke filluar nga data 09.09.2020 deri më 09.03.2021.

Udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankuesit me datë 07.10.2021 nëpërmjet e-mailit zyrtarë e njofton ankuesin se pushimi pa pagesë 6 muaj + 6 muaj ka përfunduar me datë 09.09.2021 dhe kërkon nga ankuesi që të

kthehet në vendin e tij të punës me datë 11.10.2021. Ankuesi nuk kthehet në vendin e tij të punës, sipas njoftimit të udhëheqësit të tij të drejtpërdrejt të datës 09.09.2021.

Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit sipas vlerësimit të gjendjes më datë 22.10.2021 nëpërmjet e-mailit zyrtarë e njofton Udhëheqësin e Personelit se ankuesi nuk është kthyer në vendin e tij të punës me datë 11.10.2021, dhe kërkon nga Udhëheqësi i Personelit që ti ndërmarr veprimet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Komisioni Disiplinor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike pas marrjes së kërkesës së datës 25.10.2021 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me datë 24.11.2021 merr Vendim me numër KD-01/2021 me të cilin vendim ankuesit i shqiptohet masa disiplinore **"largim nga Shërbimi Civil"**, e paraparë me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 i Ligjit Nr.06/L-114 të Ligjit për Zyrat Publike.

Ankuesi, kundër Vendimit me KD-01/2021 të datës 24.11.2021 të Komisionit Disiplinor, më datë 22.12.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Republikës së Kosovës me numër R 2028162 e cila është pranuar më datë 23.12.2021 dhe është regjistruar më numër të ankesës A.nr.1213/2021 me numër të protokollit 6302/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.01.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Këshilli më datë 21.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar me datë 23.12.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim; Vendimi i datës 24.11.2021 i Komisionit Disiplinor; E-mail-at e datave 25.10.2021, 22.10.2021, 07.10.2021, 25.10.2021, 01.11.2021, 13.11.2021, 28.09.2021, 17.06.2021, 08.09.2021, 17.06.2021; Gjendja aktuale e SMVP; Vendimi i datës 09.09.2020 për pushim pa pagesë; Akt emërimi i ankuesit; E-mail-at e datave 06.04.2021, 02.04.2021, 12.04.2021, 01.11.2021, 15.11.2021, 04.11.2021, Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 29.10.2021, Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 01.11.2021; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 16.11.2021; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 18.11.2021; Organogrami; Përshkrimi i vendit të punës i ankuesit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Bazuar në provat e lëndës, ankuesi më datë 07.09.2020 ka paraqitur kërkesë për pushim pa pagesë prej dymbëdhjetë (12) muaj apo një vit, ndërsa e njëjta kërkesë sipas provave të lëndës fillimisht është aprovuar me datë 09.09.2020 me numër të protokollit 109 nga Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për periudhë prej gjashtë (6) muajsh gjegjësisht nga data 09.09.2020 gjer më datën 09.03.2021, kështu që ankuesi përsëri me datë 02.04.2021 ka parashtruar kërkesën për vazhdim të pushimit pa pagesë edhe për gjashtë (6) muajsh të tjerë tek Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë ndërsa Udhëheqësi i drejtpërdrejtë me datë 12.04.2021 ka rekomanduar që ti aprovohet pushimi pa pagesë edhe për gjashtë (6)

muaj të tjerë. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë me datë 07.10.2021 nëpërmjet e-mailit zyrtarë ka kërkuar nga ankuesi që të paraqitet në vendin e punës pasi që pushimi pa pagesë gjashtë (6) muaj + gjashtë (6) muaj ka përfunduar me datë 09.09.2021 dhe kërkon nga ankuesi që të kthehet në vendin e punës me datë 11.10.2021, mirëpo përkundër kësaj ankuesi nuk është paraqitur në vendin e punës, me këtë është dëshmuar nga sistemi i vajtje/ardhjeve në punë, ku ankuesi nga data 11.10.2021 deri më datë 22.10.2021 nuk është paraqitur në vendin e tij të punës, për këtë fakt ndaj ankuesit më datë 25.10.2021 është iniciuar procedurë disiplinore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dëshmimeve të ofruara në dosje, konkretisht e-mailit të datës 07.10.2021 të Udhëheqësit të drejtpërdrejtë drejtuar ankuesit për kthimin në vendin e punës, konstatoi se ankuesi _____ edhe përkundër faktit që ka qenë i njoftuar se pushimi pa pagesë i ka përfunduar ankuesi nuk është kthyer në vendin e punës. Në bazë të e-mailit të datës 07.10.2021 të Udhëheqësit të drejtpërdrejtë, ankuesi është dashur që me datë 11.10.2021 të kthehet në vendin e tij të punës për të vazhduar të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara mbi bazën e Akt –Emërimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu në bazë të dëshmimeve të ofruara të vijueshmërisë në punë (hyrje-dalje) konstatoi se ankuesi _____ nuk ka qenë prezentë në punë nga data 11.10.2021, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstatoi se ankuesi me rastin e mos përgjigjes thirrjes së organit të punësimit për kthim në vendin e punës dhe mungesës së paarsyeshme, ka vepruar në kundërshtim nënin 46 paragrafin 3 nën paragrafit 3.5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se „**3.Shkelje të rënda konsiderohen „3.5.braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë”** si rrjedhojë ankuesi më mos paraqitjen e tij në punë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: **“Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik dhe Mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore”**, meqenëse ankuesi ka vepruar në kundërshtime me dispozitat e lartcekura, atëherë i njëjti ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht shkelje të rënda disiplinore, braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës së datës 25.10.2021 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: **“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”**, ndërsa Komisioni Disiplinor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike me rasatin e nxjerrës së Vendimit me KD-01/2021, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 , 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenin 50 paragrafin 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit të parashtruar me ankesën e datës 23.12.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka pretenduar se Vendimi i Komisionit Disiplinor përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës së përgjithshme administrative, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, mirëpo Kolegji ka konstatuar se Vendimi KD-01/2021 i Komisionit Disiplinor i datës 24.11.2021 është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në këtë rast Komisioni Disiplinor i Akademisë së Kosovës për



Siguri Publike Vendimin KD-01/2021 të datës 24.11.2021 e ka arsyetuar në përputhje të potë me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, sepse ka arritur të vërtetoj drejt gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1213/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
- Udhëheqësit të Personelit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.